
G CORES

Të dhënat, të cilat kanë të bëjnë me personat e dikurshëm ose aktual (redaktorët etj.) dhe organizatat, që bashkëpunojnë për formimin e burimeve në vazhdim, shënohen në një bazë të veçantë të të dhënave, e cila është e ndarë nga COBIB-i. Për çdo burim në vazhdim ekziston një regjistrim në bazën e të dhënave CORES, i cili krahas të dhënave elementare identifikuese përmban edhe të dhënat për përgjegjësitë, të cilat vazhdimisht përditësohen për nevojat e bibliografive. Baza e të dhënave CORES shërben kryesisht për ndërtimin e bibliografive personale.

Në këtë kapitull është përshkruar baza e të dhënave CORES, janë paraqitur komponentet e modulit COBISS3/Katalogimi (ndërfaqja për katalogim, dritarja për kërkim dhe paraqitësi) dhe procedurat me regjistrimet nga baza e të dhënave CORES.

Pas bazës së të dhënave CORES në shfletues është shtuar klasa e pavarur **CORES**, e cila duket vetëm me autorizimin CAT_NEWCORES. Komponentet e ndërfaqes për CORES funksionojnë sipas principeve të njëjta me komponentet në klasën **Regjistrimi bibliografik**, për këtë arsye, në këtë kapitull janë të përshkruara kryesisht ndryshimet.

Në bazën e të dhënave CORES nuk mund të krijoni regjistrime të reja për burimet në vazhdim, ato vetëm mund t'i shkarkoni nga COBIB-i dhe më pas t'i plotësoni, sikurse në COBIB.